



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 14, datë 27.11.2024

I mbledhjes së Këshillit të Bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”, mbledhje e radhës.(Ora 10:30)

Marrin pjesë:

- | | |
|--------------------|---------------------|
| 1.Vullnet Bilbilaj | 18.Marsela Dashi |
| 2.Liljana Breshani | 19.Briseida Çakërri |
| 3.Edison Kapaj | 20.Shkëlqim Leskaj |
| 4.Novrus Rrokaj | 21.Edlira Kapllanaj |
| 5.Gjergji Nika | 22.Elpiniqi Mërkuri |
| 6.Klodian Xhyheri | 23.Vjola Xhafaj |
| 7.Rajmonda Zoto | 24.Grigor Dede |
| 8.Jerina Dervishaj | 25.Ledja Shollaj |
| 9.Aurora Qarri | 26.Roland Strakosha |
| 10.Evis Allushi | 27.Atird Hoxha |
| 11.Simo Petromilo | 28.Geron Gunbardhi |
| 12.Sokol Kushta | 29.Anxhela Shenaj |
| 13.Ardian Musta | 30.Myzafer Elezi |
| 14.Ervis Moçka | 31.Brikena Sika |
| 15.Besmir Brahimi | 32.Arsen Belaj |
| 16.Endri Hyseni | 33.Bujar Osmënaj |
| 17.Elca Bezhani | |

Mungojnë:

- 1.Illir Aliaj

- 2.Brikena Puka
- 3.Simbol Pazaj
- 4.Anisa Ceno
- 5.Gëzim Çapoj
- 6.Frosina Qyrdeti
- 7.Eglantina Aliaj
- 8.Englantina Imeraj
- 9.Lorel Canaj
- 10.Eda Begaj
- 11.Liri Dëma
- 12.Mujo Shakaj
- 13.Arjan Isufi
- 14.Refie Laze
- 15.Dikens Bushaj
- 16.Eneida Vera
- 17.Alta Haluci
- 18.Erëmal Arapi



REPUBLIKA ESHQIPËRISË

BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 14/1, datë 27.11.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Çelet mbledhja me ceremoninë e dhënies së titullit të nderit Doc.Prof.Profit Canaj”Qytetar Nderi i Vlorës”

Lexon mbi jetën dhe veprën e zotit Profit Canaj si dhe, Vendimin e Këshillit të Bashkisë , për dhënien e titullit “Qytetar Nderi i Vlorës”.

Përshtëndesin gjithashtu dhe Kryetari i Shoqatës “Labëria” dhe Kryetari I Bashkisë z.Ermal Dredha.

Flet Kryetari , zoti Ermal Dredha në lidhje me kalendarin e Festave të Nëntorit.

Z.Ermal Dredha - Gëzuar dhe krenarë që jemi Vlonjatë.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Fillojmë mbledhjen. Fjalën e ka zoti Vullnet.

Z.Vullnet Bilbilaj – Shumica janë njohur me largimin para kohe nga jeta, te ish-kolegut, zotit Piro Bregaj.Të mbajmë 1 minutë heshtje.

(Mbahet 1 minutë heshtje)

Znj.Elpinqi Mërkuri – Shprehja e ligjshmërisë për VKB Nr 92-95, datë 28.10.2024, janë vlerësuar me akte individual dhe të ligjshëm nga Prefekti I Qarku Vlorë.(Lexon shkresën e ardhur nga institucioni I Prefektit të Qarkut Vlorë)

Vijojmë me Miratimin e Procesverbalit të mbledhjes së këshillit, datë 21.10.2024 dhe datë 28.10.2024 .

Votohet.

Pro – 23 vota

Kundër - 5 vota

Abstenim – 1 votë

Miratohet.

Znj.Elpinqi Mërkuri -Vijojmë me rendin e ditës.

Z.Atird Hoxha – Për procedurë. Në mbledhjen e kaluar të Konferencës së Kryetarëve , na u tha, na u komunikua krijimi i një grupi. Jeni në shkelje të Rregullores, të Nenit 28 të saj.

Zonja Kryetare. Në leximin e këtij neni, grupet e këshilltarëve krijohen 2 muaj nga konstituimi i këshillit., nuk krijohen më vonë.. I jeni referuar Nenit 4, për krijimin e grupeve të përzier Nëqoftëse, do të mbështeteshit në këtë nen, në këto kritere do të kishim ngritur shumë grupe.. Jo më kot grupet krijohen 2 muaj nga konstituimi...Prandaj , sot nuk qëndron. Është i shpjegueshëm ky nen, dhe kur bie numri nga 3 i anëtarëve të grupit..ose pushon së ekzistuari..Nuk mund të ndodhë që sot bien dakort 3-4 këshilltarë dhe nesër krijohet grupi me një shkresë .

Nuk kemi asnjë komunikim nga kryetari i grupit, zoti Moçka apo ndonjë komunikim publik për këshilltarët. Në formatin e Konferencës së Kryetarëve, janë 4 anëtarë të opozitës, pra ju jeni në minorancë në numër ...dhe jo, vota Juaj zonja Kryetare të jetë deçizive....Flitet me procedurë . Miqësisht kërkoj ta korrigjoni , ose do ndjekim hapat ligjore.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Ka diçka tjetër, lidhur me rendin e ditës?

Z.Gjergji Nika – Kërkoj një përgjigje nga administrata. Në mbledhjen e datës 28 tetor , kemi kërkuar drejtorin e ujësjellësit të ishte i pranishëm. dhe nxorret justifikim, që shkresa ka shkuar vonë. Administrata e këshillit na ka gënjyer . Pse ?

(Lexon shkresën e nisur nga ujësjellësi , bazuar në shkresën e ardhur në datën 29 tetor nga administrata)

Pse na kanë gënjyer dhe pse s'ka ardhur ?

Pse na keni gënjyer , shkresa ka shkuar të premtën,...dhe e keni nisur më vonë .

Znj.Elpinqi Mërkuri – Shkresa një ditë mbas mbledhjes së këshillit, i ka shkuar administratës. Administrata i delegon nëpër drejtoritë përkatëse. Për shkak se situata ishte e ngarkuar , i kemi rinisur përsëri shkresën drejtorit përkatës.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Lidhur me rendin e ditës, ta kalojmë në votim ?

Votohet.

Pro -23 vota

Kundër 5 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 14/2, datë 27.11.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri - Pika 1 e rendit të ditës, projektvendimi “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë, për muajin tetor 2024”.

Relaton drejtoresha.

Znj.Irena Stasa – Meqenëse në mbledhjen e Komisionit të Financës u la të shtojmë dhe numrin e Vendimit të ShSSH, Janë 3 skema : sistemi i madh dixhital, nga fondi i kushtëzuar si dhe nga të ardhurat e bashkisë, do ta vendosim numrin...Pastaj ka dhe të larguar nga sistemi, ata që kanë filluar punë. Të gjitha në rregull sipas procedurës.

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votim.

Votohet.

Pro – 29 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 14/3, datë 27.11.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 2 e rendit të ditës, projektvendimi “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për muajin tetor 2024”.

E kalojmë në votim.

Votohet.

Pro – 29 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA ESHQIPËRISË

BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 14/4, datë 27.11.2024

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Pika 3 e rendit të ditës, projektvendimi“Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së zotit Luan Skëndaj dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.

Nëqoftëse nuk keni gjë, e kalojmë në votim.

Votohet.

Pro – 29 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA ESHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 14/5, datë 27.11.2024

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Pika 4 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së zotit Ëngjell Memaj dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.

Votohet.

Pro – 29 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 14/6, datë 27.11.2024

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Pika 5 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së zotit Nuro Blushaj dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.

Votohet.

Pro – 29 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Z.Gjergji Nika – Do ti bëja një pyetje drejtorit të emergjencave.

Janë 350 familje që u përmytën dhe që presin ndihmën . Pra, kur do na vijë informacioni për familjet e mbytura.

Z.Adrian Vreshtazi – Drejtoria e Emergjencave Civile, ka punuar . Nga verifikimet , janë 365 banesa të dëmtuara. I gjithë dokumentacioni ka shkuar tek ekspertët e Qarkut për të bërë preventivat. Kur të vijë, do ti kalojmë në këshill.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 14/7, datë 27.11.2024

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Pika 6 e rendit të ditës, projektvendimi “ Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2025”.

Relaton drejtoresha.

Znj.Laura Brinja – Ky projektvendim për strukturën, numrin e punonjësve, numri nuk ka ndryshuar, vetëm me ndryshimin e pagave të Policisë Bashkiake. Duke ju referuar VKM dhe stafit të Policisë Bashkiakeqë, kërkojnë për hyrjen në fuqi të vjetërsisë. Kemi propozuar 47mijë +vjetërsi ...dhe tek kjo VKB është pasqyruar dhe ndarja e ndërmarrjeve, për shkak të një menaxhimi më të mirë të punës, për tu ndarë në NSHP; Ndërmarrje e Gjellbërimit dhe Ndërmarrja e Pastrimit.

Z.Ervis Moçka – Për procedurë, bazuar në nen. Relaton drejtoresha.

Z.Atird Hoxha – Përsa i përket këtij projektvendimi ..., bëri saktësim të ndarjes së ndërmarrjeve. Janë sektorë..Pra, krijimi i këtyre ndërmarrjeve, ka kosto financiare dhe në çfarë niveli do jenë ?

Znj.Laura Brinja – Janë të pasqyruara në tabela.

Z.Atird Hoxha – Ndërmarrja e pastrimit, sot është në varësi të NSHP, po ashtu edhe ajo e gjellbërimit.Thoni përsëri..Në Ndërmarrjen e Pastrimit, në Ndërmarrjen e Gjellbërimit...Pra, drejtori do ketë pagesë..

Znj.Laura Brinja – Efekti i vetëm , është paga e 2 drejtorëve, që do të pasqyrohen në buxhet.

Z.Atird Hoxha -Këto të dyja , krijojnë një shumë prej 30 mijë lekë, pra ka ndryshime., ka një kosto financiare. Juve do të vini të sqaroni.

Znj.Laura Brinja – Aty është niveli i pagave.

Z.Atird Hoxha – Ti sot ke sjellë vetëm strukturën. Që në moment, do ketë efekt financiar. Arsyet e administratës që do krijohen këto 2 ndërmarrje.

Përsa i përket këtij projektvendimi, është për të ardhur keq, që punëtorët e këtyre ndërmarrjeve janë më të keqpaguarit dhe që punojnë më shumë. Këtu ne nuk do miratojmë vetëm krijimin e dy oligarkive, por të krijojmë kushtet minimale

Rrisni pagën e këtyre punonjësve , të Policisë Bashkiake, Këtyre punonjësve të thjeshtë u rrisni pagën...Mendoj që këto rritje të reja janë të pavlera..1476 persona marrin rrogën në Bashkinë Vlorë.

Z.Ervis Moçka – Ndahet projektvendimi në 2 pjesë.

1.NSHP ndahet në 2 ndërmarrje, për menaxhim më të mirë . S’ka efekte financiare,thotë drejtoresha, por në fakt ka efekt financiar , vetëm për pagën e 2 drejtorëve. Do përballohet nga fondi i pagave, pra nga përgjegjës sektori, në drejtor, ky është efekti financiar.

2.Përsa i përket pjesës së dytë , jam dakort, vjen projektvendimi me uljen e pagave të Policisë Bashkiake. Ka ndryshim page me ulje e Policisë Bashkiake, pasi VKM e re, nuk ka tabelë për pagën e Policisë Bashkiake. Nuk jam dakort për uljen e pagës së Policisë Bashkiake, përkundrazi , të gjendet mundësia e gjetjes së bazës ligjore. I takon administratës, juristëve . emi dakort t’ju rritet paga gjithë punonjësve të thjeshtë.

Pretendimi ka qenë, tu ulet paga nga 54 mijë në 47 mijë, për Policinë Bashkiake, pasi VKM nuk ka parashikuar tabelë. Arsyetimi është bërë , është ulur paga , por është rritur me vjetërsinë, bazuar në VKM. Por Ligji “Për Policinë Bashkiake “ e rregullon sipas Kodit të Punës, kështu që, VKM përcakton apo jo ...Por mos të ulet paga e Policisë Bashkiake dhe tu shtohet vjetërsia . Pra, t’ju rritet paga Policisë Bashkiake dhe gjithë punonjësve të thjeshtë të NSHP.

Z.Klodian Xhyheri – Ne nuk e kuptojmë, pse nuk rriten pagat e punonjësve të thjeshtë. Patjetër do ta keni votën time, por pse nuk e bëtë më parë . Rrituni rrogat ...Ju shikoni drejtorë e specialistë..Sytë nga punonjësit.

Z.Gjergji Nika – Duke u bazuar dhe tek fjala e kryetarit të grupit të pozitës. Ne kemi qenë gjithnjë për rritjen e pagave. Shoë mos të bëhet sot. Pse e bëni sot?

NSHP është ndarë , që kur kemi kaluar 2 nëndrejtorët . Nuk ka lidhje kjo ndarje. Ne kërkuam në komision një raport analitik dhe një raport analizë,pse do bëhet ndarja. Problemi është që, relacioni dhe përgjigjet që na sillni, bini brenda vetë...Lexon ..130 punonjës tek pastrimi...,130 tek gjelbërimi rritja e volumit...Madje dhe kërkesa e llogarisë nuk është e mundur . Në mbledhjen e komisionit, kam dhënë dakortësinë për strukturën, por neutral për ndarjen e NSHP. Kërkova një raport analitik dhe financiar Në çdo raport apo relacion , shoh që nuk ka emër drejtori, por vetëm emri i Kryetarit të bashkisë. (Lexon projektvendim..relacioni...)

Z.Ervis Moçka – Përmendi disa momente ...Nuk po bëjmë politikë. Pagat u rritën në të gjithë Shqipërinë. Në komision nuk kemi kërkuar uljen e pagës së Policisë Bashkiake dhe të punonjësve të thjeshtë. Biem dakort, por jo, pse tani ? Ju la detyrë administratës të gjejë bazën ligjore..Përsa i përket mënyrës së organizimit, po kapeni tek relacioni .Nuk mendoj se ka një efekt të madh financiar për 2 drejtorë...Nëqoftëse, kjo më vonë nuk funksionon,prpozohet që mënyra të jetë ndryshe. Kjo është zgjedhje e titullarit, Kryetarit të Bashkisë dhe e sjell për vendimmarrje. Dhe ne nesër mund të kërkojmë llogari, pse su bë? Por nuk e kuptoj të digjet ky projektvendim, pasi digjet dhe Policia bashkiake, rritet paga dhe shtesa e vjetërsisë për Policinë bashkiake...Ju ftoj të gjithëve ta votojmë.

Z.Gjergji Nika – Policia Bashkiake në strukturën që ka sjellë administrata, kemi pas debate në komision me Drejtoreshën e Burimeve Njerëzore. Paga ishte 54 mijë + vjetërsinë, dhe të bazuar në Kodin e Punës ..Për këtë jam dakort, por për ndarjen e NSHP bëni një ristrukturim. Më sillni një raport analitik, një analizë financiare ..

Z. Ervis Moçka – U diskutua në Komisionin e Financës, pasi e diskutuam dhe ne në Komisionin Juridik..Përse nuk votoni , kur dy komisionet bien dakort.

Z. Endri Hyseni -Për pjesën e Policisë Bashkiake, jo vetëm që nuk do ulen , përveçshtimit të vjetërsisë, do shtohet dhe vlerësimi për vështirësi të punës. Pra, mos të ulet paga e Policisë Bashkiake +vjetërsi+vështirësi..A kërkojmë shërbim më të mirë dhe s'ka asgjë të keqe.

-Lexon titullin e projektvendimit...Dy ndërmarrjet që krijohen, të shtohet tek titulli i projektvendimit, si dhe.. për krijimin e Ndërmarrjes së Pastrimit dhe Gjelbërimit dhe, më pas tek prefekti dhe me pas për numër fiskal.

Znj.Anxhela Shenaj – Si e mat produktivitetin e këtyre punonjësve .., të këtyre shërbimeve ?

Për rritjen e pagës së Policisë Bashkiake, vjetërsi, nuk është rritje page, është e drejtë ligjore që i jepet punonjësve.

Z.Grigor Dede – Miratimi i strukturës , bëhet para miratimit të buxhetit, i cili është detyrim ligjor. Pra, po s'u miratua struktura, nuk miratojmë dot buxhetin.

-Shkrija e NSHP në 3 ndërmarrje..Kur kjo ndërmarrje.. që, kur mori pastrimin, shërbimin funeral u vështirësua puna. Ky është një ndryshimi i vetëm, që bëhen 2 drejtorë .

Pra, ta miratojmë strukturën kështu siç është ...Si VKM aktuale dhe e mëparshmeja , nivelin e pagave të Policisë Bashkiake , nuk e përmend.

Paga ka qenë 54.900, një e drejtë e përfituar..Paga 47 mijë e kundërshton. Paga do ngelet 54.900, të shtohet dhe vjetërsia se nuk është llogaritur.E ka dhe Ligji “Për Policinë Bashkiake “, gjithashtu bazuar dhe në Kodin e Punës. Pra, paga 54.900 + vjetërsi.

Znj.Elca Bezhani – Në Komisionin e Ekonomisë, u diskutua ky projektvendim. Ishim dakort me këto pika ,por u propozuan disa ndryshime. Në projektvendim duhet të pasqyrohen qartë, krijimi i 2 ndërmarrjeve.

-Të përcaktohet ndryshimi i formës, nga sektor në ndërmarrje.

-Përcaktimi i vendndodhjes ..nëqoftëse, administrata e ka vendosur në NSHP.

-Struktura dhe krijimi i këtyre ndërmarrjeve është kopetencë e Kryetarit të Bashkisë.

-Ndërmarrjet duhet të marrin në organte tatimore, NIPT-in në QKB.

Zoti Nika, kërkoi një analizë ekonomike për krijimin e 2 ndërmarrjeve, për kostot financiare.

-Relacionin e marrë para mbledhjes, jo analizë ekonomike.

DBNJ ka përcaktuar me tabela dhe e udhëzuar që të kishte një bashkëpunim me strukturat e NSHP, për analizën e kostos financiare...

-Të korrigjohet relacioni , të vijë me analizën e kostos financiare të ndërmarrjes së NSHP, në Pastrim dhe Gjelbërim.

Më duket e pavend, që ti bëhet shkresë administratës, me kërkesat tona, kur ata janë prezentë.

-Për pagat e Policisë Bashkiake , u ra dakort të ngelen 54.900, t'ju njihej dhe vjetërsia. Deri dje nuk është marrë parasysh llogaritja e vjetërsisë . Ju la detyrë administratës të bëjë kërkimet, kalkulimet e duhura.

-I kërkojmë administratës që pagës së Policisë Bashkiake ti shtohet vjetërsia 1% çdo vit deri në 25 vjet , mbi pagën 47mijë.

-Në lidhje me vështirësinë në punë, u la të komunikohet me NJVKSH.(Bashkëlidhur relacioni)

Znj.Anxhela Shenaj – Nuk ka nevojë të miratohet ...

Znj.Elpiniaq Mërkuri – Do të kërkoja , lidhur me Policinë Bashkiake,lidhur me mos uljen e pagës, lidhur me vjetërsinë dhe vështirësinë ...Ta kalojmë në votim këtë pjesë.

Z.Daut Zëraj – Janë 3 pika:

1-Është niveli i pagave

2-Numri i punonjësve dhe

3-Krijimi i ndërmarrjeve.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Siç e cilësoi dhe kryetari i komisionit, për Policinë Bashkiake , mos të ulet paga , të njihet vjetërsia dhe vështirësia , të komunikohet me shkresë institucionit Votohet.

Pro – 29 vota

Kundër -0 vota

Abstenim – 0

Miratohet.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Për numrin e punonjësve , kalojmë në votim

Pro –

Z.Atird Hoxha – Janë shumë punonjës..1476 në Bashkinë Vlorë.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Po ky numër është, s’do heqim njerëz nga puna.

Votojmë ndarjen e NSHP .

Pro – 22 vota

Kundër – 7 vota

Abstenim – 0 vota

S’miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 14/8, datë 27.11.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 7 e rendit të ditës, projektvendimi “Për shprehjen e dakortësisë për nisjen e procedurave për transferimin në pronësi të Bashkisë Vlorë, të Pasurive Nr 36/179, Sipërfaqe 317,98m², ZK 8602, Pasurisë Nr 36/76, Sipërfaqe 832, 4m², ZK 8602, Pasurisë Nr 32/107, Sipërfaqe 390m², ZK 8604, Pasurisë Nr 32/524/1, Sipërfaqe totale 552m², ZK 8604, Pasurisë Nr 32/399, Sipërfaqe 32833 m², ZK 8604, Pasurisë Nr 32/106, Sipërfaqe 390m², ZK 8604”. Për këtë projektvendim, kush do relatorojë, drejtori juridik apo i aseteve ?

Z.Dorian Demiri – Ky projektvendim, zërat kadastralë të këtyre pasurive shtet, do të kalojnë në pronësi të bashkisë. Në thelb , s’kemi tjetërsim..Nëqoftëse do të ketë ...

Z.Klaudio Mehmetaj – Janë planvednosjet bashkëlidhur, hartat kadastrale. Çdo praktikë, çdo numër pasurie ka hartën.

Z.Gjergji Nika - Nuk kemi hartat, planvendosjet. Kemi vetëm numër pasurie. Ku janë këto prona ?

Z.Endri Hyseni – Ky projektvendim, (lexon) me këtë propozim, kemi të bëjmë me një çështje teknike. ...Thjesht po fitojmë një pronësi...nga çështja teknike..Vetëm të kalojmë në pronësi të bashkisë këto prona. Vetë këshilli me votën e tij , do ta miratojë më vonë..Thjesht për procedurë, që të kalojë për rregjistrim në ASHK.

Z.Gjergji Nika – Këshilli bashkiak është pronar i pranoave. ..Bashkia është pronare, Këshilli vendos. Ku janë hartat ? Nuk kanë ardhur.

Ku janë këto prona..mos kemi problematika të tjera, mos ka probleme me ALUIZNI-n, janë prona me kufizime etj..

Z.Atird Hoxha – Ky projektvendim ...Pyetja e parë.

-A ka ndonjë subjekt të interesuar për ZK 8602, Nr.Pasurie 3676 me sipërfaqe ...; ZK 8602.....

-A ka paraqitur ndonjë subjekt interesim për këto pasuri...; ka vetëm numër pasurie..por harta, nuk ka.

Janë dhe 4 zona në ZK 8604 ose Rajonin Nr 4.

Normalisht, ne si këshilltar mendojmë që ka një prapavijë ...Pra sot , miratohet ky projektvendim dhe më vonë vjen një subjekt i interesuar privat, për tjetërsim ...Më duket që ky projektvendim është i porositur, por kjo nuk është procedura. Për çfarë duhet të japim paraprakisht dakortësinë.

Po të shikojmë tek ky projektvendim, në fjalinë e fundit...lexon.....pra, na jep indicie që ky është i porositur.

Ky projektvendim është i palotë, pa harta. Janë disa prona me sipërfaqe të çuditëshme. Sipërfaqet e vogla, për çfarë i duhen bashkisë.

-A ka subjekt të interesuar për të zhvilluar pronën, A ka kërkesa ? Vota ime është kundër , ka ca paqartësi.

Z.Myzafer Elezi – Në mbledhjen e Komisionit Juridik , u propozuan ndryshime, u diskutua dhe u votua 5 me 0. Përse nuk është bërë ndryshimi në projektvendim, pse s'është zbardhur ?

Z.Daut Zëraj – Do ndryshojë, kur të zbardhet vendimi.

Z.Ervis Moçka – Nga të gjitha ato që u diskutuan, që të ketë persona të interesuar ...A ka kërkesa...S'ka asgjë të paligjshme...

Për transparencë, duhej të merrej përgjigjja e kërkuar.. S'ka asgjë që një subjekt të bëjë kërkesë për zhvillimin e pronës...Do bëhen të gjitha procedurat.

A ka persona të përfshirë,...Ose, meqenëse gjithë këshilltarët kërkojnë hartat, i sillni hartat.

Ky projektvendim, është me urgjencaë? A ka ndonjë kërkesë që pret apo është iniciativa juaj. Të vijmë dhe hartat dhe ta kalojmë.

Z.Sokol Kushta – Këto janë prona të vogla, që duken sikur nuk prishin punë. Unë kam një projekt ..Është një vonesë shumë e gjatë, s'po marr përgjigje . Është një zonë me plehra dhe, unë dua ta zhvilloj atë pronë..Unë jam pro të zhvillohet çdo pronë , çdo zonë, Bashkia do marrë përfitimet e veta. Po ju bëj një pyetje. Përse ajo prona e Bashkisë që do zhvillojnë aktivitete sportive shkollat , s'po marr përgjigje. Unë ndihem i ofenduar, që vijmë prona që nuk janë diskutuar. Dua të më kthehet dhe mua përgjigje për pronën që kërkoj.

Z.Gjergji Nika - Nëqoftëse, doni të na bindni , na sillni informacion. Në Konferencën e Kryetarëve erdhi dhe një projektvendim dhe ne e hoqëm , pasi duhet të bëhet dëgjesa publike.840 ha...loboni që kjo mos të vijë në mbledhjen e Këshillit.

Z.Atird Hoxha – Falënderoj zotin Kushta për shqetësimin shumë qytetar që solli. Përsa i përket këtij projektvendimi, kam një pyetje tjetër.

A janë të sigurta që, këto numra pasurish, nuk janë pjesë e AMTP-ve, që ka të bëjë me tjetërsim trualli..... ka pas prona të kufizuara.

Për këto prona , administrata, a ka marrë ndonjë informacion nga ASHK, pasi këto prona mund të jenë në proces legalizimi, mund të jenë në trajtim me Ligjin 7501.., Pra a ka pas korrespondencë me institucionet në lidhje me këto pasuri ...Pra, ka shumë problematika ky projektvendim.

-A ka një subjekt që ka paraqitur kërkesën ?

-A ka pas një korrespondencë me institucionet e ASHK,Legalizimeve, ATP etj..?

Z.Dorian Demiri – A ka pas verifikime ..Praktikisht, kërkohet shprehje e dakortësisë, pra nisja e procedurave . sapo të miratohet dakortësia, do bëhet gjithë procedura . S'po bëjmë tjetërsim prone. Do fillojmë me procedurën.

-Ka pas kërkesa nga subjekte të ndryshme. Jemi në fazën fillestare . Për çdo propozim , do vijmë prapë në këshill.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Ka ndonjë urgjencë ky projektvendim ?

Z.Dorian Demiri – Jo. Ne hrtat i kemi , por dhe mbledhjen tjetër.

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Ky projektvendim do shtyhet , dhe projektvendimet e tjera do shtyhen.
S’kemi kuorum për të vazhduar mbledhjen.
Mbyllet mbledhja për ditën e sotme.